

LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 9: Shtator - Dhjetor 2021



Përhëndetje të nderuar prindër,

Edhe ky vit shkollor ka nisur me sfidat dhe të mirat e veta.

Fatmirësisht nxënësit patën mundësinë të uleshin në bankat e shkollës e jo të ndiqnin mësimin nga shtëpia. Ne si shkollë morëm të gjitha masat që të ishim të përgatitur për çdo situatë që do të na paraqitej. Sigurisht kjo do të thotë sfidë, angazhim dhe punë më e madhe. Krahas sigurimit të kushteve fizike të përshtatshme për të zhvilluar mësimin në ambientet e shkollës, ajo çfarë na tronditi më fort është largimi nga jeta në mënyrë të papritur e mësueses tonë të letërsisë znj. Anila Bazelli. Kjo humbje preku thellë edhe gjendjen emocionale të kolegëve dhe sigurisht të të gjithë nxënësve, të cilëve ajo iu jepte mësim prej vitesh.

Orët e mësimin të mësuese Anilës u morën përsipër nga mësuese Poljona Busho, e cila ishte tashmë pjesë e stafit tonë.

Megjithë kufizimet e vendosura, krahas mësimdhënies, ne kemi arritur të kryejmë e zhvillojmë të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin shkollor, të tilla si: takime me prindër, aktivitete kulturore-artistike, projekte sociale, projekte shkollore, aktivitete ndërgjegjësuere etj. Nuk na ka munguar dëshira që edhe ju të ishit pjesë e këtyre aktiviteteve, por kufizimet në numrin e pjesëmarrësve nuk na e kanë lejuar një gjë të tillë. Megjithatë ne ju mbajmë me kënaqësi gjithmonë të informuar nëpërmjet grupeve të përbashkëta në WhatsApp, apo edhe postimeve në blogun e faqes

së internetit të shkollës, të cilën ju ftojmë ta vizitoni vazhdimisht.

Pandemia dhe zhvillimet e koronavirusit vazhdojnë të jenë një sfidë e përditshme për të gjithë ne. Prandaj ajo që shpresojmë të gjithë është që ju, nxënës, mësues e prindër të gëzoni shëndet të mirë me qëllim që ta mbyllim me sukses këtë vit shkollor.

Ju urojmë festa të gëzuara, shëndet dhe mbarësi për vitin 2022!

Me respekt,
Elona Rira
Drejtoresh e Shkollës NEHEMIA

elona.rira@ng.team

SHTATOR

Dita e gjuhëve të huaja

Me rastin e ditës europiane të gjuhëve u zhvillua mësimi në orën e gjermanishtes me temë "Endeck Europa" (Zbuloni Evropën) në të tre ciklet. U përdorën metoda moderne të mësimdhënies (puna me stacione) në bashkëpunim me praktikantët gjermane.

Rëndësia e gjuhëve të huaja në ditët e sotme sa vjen dhe po rritet dhe ne duam që fëmijët tanë të ndërgjegjësohen për këtë.

Werner Hoyer

Në javën e fundit të shtatorit kishim gjithashtu privilegjin të kishim në Shkollën NEHEMIA Werner Hoyer dhe familjen e tij. Werner Hoyer kryen trajnime të herëpashershme në lidhje me sigurinë në rrugë, rregullat dhe rreziqet në qarkullimin rrugor etj.

Këtë herë, bashkë me dy djemtë e tij, ai trajnoi nxënësit mbi moshën 14-vjeçare me anë të syzeve stimuluese, të cilat, pasi i vendos, krijojnë të njëjtin efekt që droga ose alkooli ka tek truri, dhe tregojnë çfarë do të thotë të ngasësh makinën nën efektin e tyre.

Sidomos në kuadër të problematikave dhe numrit të aksidenteve në vendin tonë trajnime të tilla afatgjata shpëtojnë jetë.



TETOR

Tetori muaji i letërsisë

Kur vjen muaji tetor, nxënësit përgatiten të performojnë vjersha, këngë, të promovojnë libra të ndryshëm dhe të nxisin rëndësinë e letërsisë në jetët tona. Edhe këtë vit, me iniciativën e tyre dhe në homazh të mësueses së tyre Anila Bazellari, ata u mbledhën për të dhënë një shfaqje letrare dhe për të treguar talentet e tyre.

Nata e Bardhë

Më 15 tetor, senati i shkollës organizoi këtë aktivitet edukues-zbavitës me dhe për nxënësit e gjimnazit. Ata zhvilluan kuice të ndryshme dhe "talent shows". Kjo mbrëmje e këndshme u përmbyll me një film edukativ të moshës së tyre.

Sesioni informues për përdorimin e shëndetshëm të mediave digjitale

Më 13 tetor Susi Ruckdeschel dhe djali i saj David, së bashku me Andy dhe Gian Paul Ardüser, ftuan prindërit e interesuar për të mësuar rreth përdorimit të shëndetshëm të mjeteve digjitale. Pavarësisht avantazheve dhe të mirave që sjellin celulari, tableti, kompjuteri etj, ne e dimë që nëse nuk e frenojmë veten apo fëmijët tanë, ato na vjedhin shumë kohë të çmuar.

CNN "Call to Earth" Day

Si pjesë e projektit të CNN "Call to Earth" (dhe të projektit "Tatort Wald" nga Goethe Institut), mësues të gjermanishtes dhe biologjisë nga Shkolla NEHEMIA zhvilluan një projekt të titulluar Tatort Wald. Ky projekt u fokusua në njohjen e nxënësve me hapësirat pyjore, rëndësinë e tyre për mjedisin dhe biodiversitetin, si dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për të vlerësuar dhe ruajtur këto hapësira në vend që t'i shkatërrojnë ato.

Ky projekt vazhdoi edhe në nëntor, ku afërsisht 150 nxënës nga Shkolla NEHEMIA dolën nga liqeni për të pastruar mbeturinat.



NËNTOR

Më 1 nëntor, me ndihmën e projektit të punës sociale, Shkolla NEHEMIA organizoi projektin e saj vjetor social për të ndihmuar disa familje që jetojnë në zonën e Pogradecit. Senati i shkollës organizoi mbledhjen e ushqimeve, veshjeve dhe disa produkte higjienike. Këtë vit projekti u zhvillua në bashkëpunim me shkollën "Muhamer dhe Esat Minarolli" nga Pogradeci.

Festat e nëntorit

Fëmijët e kopshtit, midis aktiviteteve të ndryshme shkollore, në muajin nëntor kanë shkuar edhe në teatër, gjë që i gëzon dhe i argëton fëmijët tanë të vegjël. Gjithashtu, në fund të muajit, me rastin e festave të nëntorit, ata festuan me njëri-tjetrin duke kërcyer, kënduar dhe duke u identifikuar me veshjet e tyre kuq e zi dhe me tullumbacet përkatëse.

Por edhe nxënësit e gjimnazit përgatitën një koncert me recitime dhe këngë të ndryshme me rastin e 28 dhe 29 nëntorit.



DHJETOR

Krahas testimeve për të cilat të gjithë nxënësit u përgatitën seriozisht dhe intensivisht, nxënësit e gjimnazit morën pjesë edhe në olimpiadën në rang qarku "Rroke Shkencën", e cila u zhvillua në datat 6 – 10 dhjetor dhe ku nxënësit e shkollës NEHEMIA morën vendin e parë në biologji dhe vendin e dytë në shkencat sociale.

Gjatë kësaj kohe u zhvilluan edhe sesionet informuese me nxënësit, mësuesit dhe prindërit kundër drogës. Chris Lipski, punonjës policie me përvojë më shumë se 18-vjeçare në departmanetin e antidrogës në Gjermani, tregoi për efektet shkatërruese të drogërave duke sjellë shembuj dhe histori të ndryshme nga e përditshmja e tij.

Na ndiqni në facebook:

www.facebook.com/NehemiahGateway

Skano për të lexuar online!



Shkolla NEHEMIA

Nehemia 7304 Buçimas,
Pogradec Albania

Tel.: +355 83 600 403

Fax: +355 83 600 405

shkolla-nehemia@ng.team



I UROJMË MIRËSEARDHJEN

Denida Hysenbegasi

Kam mbaruar fakultetin e mësuesisë në arsimin fillor. E zgjedha këtë profesion, sepse më ka pëlqyer gjithmonë të punoj me fëmijët. Tani po punoj me ta dhe jam më se e bindur për zgjedhjen që kam bërë. Jam akoma duke mbledhur përvojë. Kam kryer praktikën profesionale njëvjeçare në një shkollë publike të Pogradecit, e cila ka qenë një eksperiencë e vështirë, por shumë e bukur dhe me vlerë për mua. Te Shkolla NEHEMIA jap mësim në filllore, si asistente.



Poljona Busho

Jam diplomuar në vitin 2018 në degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Kam përfunduar masterin profesional për mësuesi në 2020 në Fakultetin e Filologjisë në Tiranë. Kam punuar në mënyrë vullnetare në një qendër ndaj kujdesit të fëmijëve me aftësi ndryshe. Jam punësuar te Shkolla NEHEMIA si mësuese e lëndës Gjuhë dhe Letërsi në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë.



Alma Ibro

Kam mbaruar fakultetin e mësuesisë në arsimin fillor dhe ushroj profesionin si mësuese që prej 10 vitesh. Kam punuar 5 vjet si punonjëse e projektit social për fëmijët me probleme sociale-ekonomike pranë shkollës "Amaro Tan". Dy vjet kam punuar pranë fondacionit "Terre des hommes" për fëmijët me rrezik trafikimi. Gjatë gjithë këtyre viteve jam munduar të punoj me korrektësi dhe të zbatoj me përgjegjësi çdo gjë që më është ngarkuar. Këtë vit jam duke dhënë mësim në klasën e katërt të Shkollës NEHEMIA.



Kudret Durollari

Mësues i edukimit figurativ prej 15 vitesh, me stazh pune në shkollat e qytetit të Pogradecit. Kam mbaruar liceun artistik në degën Grafik në vitin 1980, në Universitetin e Arteve Tiranë dhe në 2013 në degën Skenografi, Kostumografi, si dhe kam marrë pjesë në shumë ekspozita kombëtare e ndërkombëtare. Lëvroj shumë teknikën e peizazhit. U mësoj fëmijëve të klasave I – IX vizatim dhe pikturë.



Praktikantet

Përshëndetje, ne jemi Lena dhe Kim, dy studente në Universitetin Ludwig Maximilians në Mynih. Aty ne studiojmë për mësuesi në shkollën filllore. Me ndërmjetësimin e universitetit, ne patëm mundësinë të bënim një praktikë në Shkollën NEHEMIA në periudhën 29.09. – 10.10.2021. Ne donim të mësonim më shumë rreth jetës dhe njerëzve në Shqipëri, prandaj vendosëm të bënim një praktikë në këtë shkollë. Për pesë javë ne shoqëruam dhe mbështetëm mësueset e gjermanishtes në klasë, ku mësuam dhe fituam shumë përvojë. Na ka lënë veçanërisht përshtypje atmosfera e ngrohtë në shkollë dhe e gjithë organizata Nehemiah Gateway. Jemi shumë të lumtur që kaluam një kohë kaq të bukur këtu dhe që takuam kaq shumë njerëz të mirë dhe të gatshëm për të ndihmuar.

